



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE
MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

/ Direktorat za Ekonomski Razvoj / Directorate for Economic Development

Data/ Datum/ Date:	17.11.2020
Nr./ Br./ No:	04/34
Për/ Za/ To:	Fermerët e Komunës së Shtimes
Përmes/ Preko/ Through:	Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Nga/ Od/ From:	Fitim Hoxha, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik
Lënda/ Predmet/ Subject:	Thirrje për Aplikim

Duke u bazuar në: Nenin 62, Paragrafi 62.3 i Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale;
Nenin 5, Paragrafin 5.1 dhe 5.2, Neni 19, Paragrafi 19.1 të Rregullores Nr. 01-060/01-24495/17 për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik bën;

Thirrje Për Aplikim

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Shtimes të cilët kultivojnë kultura të ndryshme bujqësore në serra, që të aplikojnë për subvencione në lëmin e bujqësisë. Mënyra e subvencionimit do të bëhet me pagesë direkte. Shuma e subvencionimit në këtë thirrje është 4070 euro.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/ aplikuesit në këtë thirrje:

- ✓ Të kenë mbi 10 ari perime të mbjellura në serra në vitin 2020.
- ✓ Të jenë banorë rezidentë të komunës së Shtimes;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- ✓ Kopja e një dokumenti identifikues të vlefshëm të Republikës së Kosovës;
- ✓ Numri identifikues i fermerit (NIF);
- ✓ Konfirmimi i llogarisë bankare;
- ✓ Vërtetimi mbi tatimin në pronë.
- ✓ Konfirmimin e MBPZHR për subvencionet e fituara për vitin 2020 ose formularin e aplikimit për subvencione ne MBPZHR.

Koha dhe mënyra e pranimit të kërkesave:

- ✓ Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 17.11.2020 deri me 01.12.2020
- ✓ Kërkesa duhet të plotësohet dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të bashkangjitura duhet të adresohen Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik, përmes zyrës pritëse të komunës;
- ✓ Të gjitha kërkesat do të shqyrtohen nga komisioni vlerësues për ndarje të subvencioneve.

Vërejtje:

- Fermerët të cilët kanë qenë përfitues nga subvencionet e ndara nga Komuna e Shtimes ne vitin 2020 përjashtohen në vlerësim.
- Fermerët të cilët nuk e kanë zbatuar kontratat të nënshkruar nga ana e tyre dhe Komuna e Shtimes gjatë 3 viteve paraprake, përjashtohen në vlerësim.

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës